Funded by the European Union

BE-ja për ekonominë qarkulluese dhe qytetet e jetueshme (EU4CELC)



Duration: 01.10.2023 - 31.05.2027

Countries:
Albania

EU contribution: € 10 600 000

Total budget: € 14 600 000

Implementer:
Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ)

Website(s): Circular Hub Albania

Project description:

Projekti “BE-ja për ekonominë qarkulluese dhe qytetet e jetueshme” mbështet kalimin e Shqipërisë nga një sistem linear në një sistem qarkullues të menaxhimit të mbetjeve. Ai fuqizon bashkitë e sotme, për të ndërtuar qytetet e së ardhmes, përmes standardeve të qëndrueshme dhe neutrale ndaj klimës për infrastrukturën dhe shërbimet publike, me synim mbrojtjen e mjedisit. I mandatuar nga BE-ja dhe Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ), si dhe i zbatuar nga GIZ Albania në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Mjedisit (MM), projekti forcon kapacitetet kombëtare dhe vendore për t’u përafruar me kuadrin ligjor (acquis-në) të BE-së (Kapitulli 27), Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane dhe Planin e Veprimit për Ekonominë Qarkulluese.
Projekti, në nivel kombëtar, nxit skemat e Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit (EPR) për ambalazhet, mbetjet e pajisjeve elektrike dhe elektronike (WEEE) dhe bateritë; përmirëson mbledhjen dhe zbatimin e të dhënave digjitale, të ndjeshme ndaj dimensionit gjinor, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit; si dhe krijon Organizata të Përgjegjësisë së Prodhuesit (PRO) së bashku me procedurat dhe udhëzimet përkatëse.
Projekti, në nivel vendor, bashkëpunon me 15 bashki, për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve përmes parandalimit të mbetjeve, rritjes së normave të riciklimit dhe kompostimit. Projekti mobilizon një Mekanizëm Financimi për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVV) dhe skema grantesh për pjesëmarrjen e sektorit privat, me qëllim nxitjen e shërbimeve të gjelbra dhe modeleve qarkulluese të biznesit, të cilat zgjasin ciklin jetësor të produkteve, ulin kërkesën për burime dhe minimizojnë ndikimet mjedisore.
EU4CELC përmirëson kushtet e jetesës së qytetarëve shqiptarë dhe krijon mundësi punësimi në zonat urbane përgjatë zinxhirëve qarkullues të vlerës, për një Shqipëri të begatë.

Expected results:

- miratimi dhe funksionalizimi i një kuadri rregullator dhe ekonomik në përputhje me BE-në, përfshirë masat për parandalimin e mbetjeve dhe ndarjen e tyre në burim;
- nisja e skemave të Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit (EPR) për ambalazhet, mbetjet e pajisjeve elektrike dhe elektronike (WEEE) dhe bateritë, me të paktën një Organizatë të Përgjegjësisë së Prodhuesit (PRO) funksionale dhe procedura të qarta për prodhuesit/operatorët.;
- AKM-ja dhe AKUK-u përdorin sisteme të profesionalizuara, digjitale dhe të ndjeshme ndaj dimensionit gjinor për menaxhimin e të dhënave, monitorimin, raportimin dhe zbatimin e legjislacionit;
- përmirësimi i ofrimit të shërbimeve bashkiake në 15 bashki, me rritje të normave të riciklimit dhe kompostimit, si dhe ulje të sasisë së mbetjeve të mbetura;
- zbatimi i Mekanizmit të Financimit dhe skemave të granteve, me mbështetje për të paktën 70 NVM, start-up-e dhe OJF; krijimi i 120 vendeve të reja të gjelbra të punës, ku 62% e tyre zihen nga gra dhe 36% nga të rinj.